

VENDIM
Nr. 65, datë 11.4.2022

**MBI SHTYRJEN E VENDIMARRJES SË BORDIT TË ERE-s PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “SPV BLUE 1” SHPK, NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK
“BLUE 1”, ME VENDNDODHJE NË ZONËN E SHEQ MARINAS, BASHKIA
FIER, ME KAPACITET TË INSTALUAR 50 mw**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 67, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, dhe nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.4.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 434/7 dhe 434/7-1 prot., datë 8.4.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘SPV Blue 1’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik ‘Blue 1’, me vendndodhje në zonën e Sheq Marinas, Bashkia Fier, me kapacitet të instaluar 50 mw”,

konstatoi se:

Në vijim të relatimit në mbledhjen e Bordit të datës 11.4.2022, të relacionit të protokolluar me nr. 434/7 prot., datë 5.4.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘SPV Blue 1’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik ‘Blue 1’, me vendndodhje në zonën e Sheq Marinas, Bashkia Fier, me kapacitet të instaluar 50 mw”, lindi nevoja për të sqaruar me shoqërinë çështjet që kanë të bëjnë me:

- fillimin e punimeve të centralit dhe çdo sqarim që lidhet me afatin e vlefshmërisë së licencës;
- financimin e ndërtimit të centralit dhe nënshkrimin/depozitimin e marrëveshjes së financimit;
- pajisjen me certifikatë pronësie për pasuritë me nr. 535/3, nr. 622 dhe nr. 537, për të cilat është bërë me dije se pagesa e kështit të fundit do të kryhet brenda muajit prill 2022.

Në të tilla rrethana, për të mundur sqarimin e sa më sipër, vlerësohet shtyrja me 30 ditë pune e vendimmarrjes përfundimtare të Bordit të ERE-s për licencimin e shoqërisë “SPV Blue 1” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shtyjë me 30 (tridhjetë) ditë pune vendimmarrjen e Bordit të ERE-s, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “SPV Blue 1” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga centrali fotovoltaik “Blue 1”, me kapacitet të instaluar 50 mw.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti